



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 19 MAJ 2022

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 19. MAJA 2022. GODINE

MAJ - MAJ  
2022

## **Rendi i ditës**

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
2. Pyetjet parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca plenare e mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-074 për turizmin,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-113 për Policinë Ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-133 për Komisionarin Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

## **Dnevni red**

1. Deklarisnja van dnevnog reda,
2. Parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-074 o turizmu,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-113 o vojnoj policiji u Bezbednosnim snagama Kosova,
6. Prvo razmatranje nacrta zakona br. 08/L-133 o parlamentarnom povereniku za Bezbednosne snage Kosova.

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.**

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,

Po fillojmë me seancën,

I nderuar ministër,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2022.

Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, qysh nga data e sodit deri më 23 maj ka ndodhur njëra ndër masakrat më të rënda që e kemi pasur në vendin tonë është masakra e Dubravës, ku më shumë se 100 djem dhe burra janë vrarë, ka ende të zhdukur dhe kemi prej atyre që kanë mbijetuar dhe ende tregojnë atë pjesë të historisë të rëndë dhe të dhimbshme që kemi pasur në vendin tonë.

Kërkoj që të mbajmë një minutë nderim për ata që janë vrarë, por edhe për familjet e tyre.

*(Një minutë heshtje)*

Përherë do t'i kujtojmë të gjithë ata që kanë rënë, dëshmorët e vendit tonë, përherë do t'i mbajmë në kujtesë familjet e tyre. Lavdi!

Vazhdojmë me pikën e parë:

### **1. Deklarimet jashtë rendit të ditës**

Koha është e kufizuar për 30 minuta në këtë pikë, 5 minuta kanë të drejtë deklarimi në emër të Grupit Parlamentar, ndërsa 3 minuta diskutimi i deputetit.

Nga Lëvizja Vetëvendosje fjalën e ka Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, në emër të grupit.

ARBËRESHË KRYEZIU-HYSENI: E nderuar nënkryetare e Kuvendit,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Të shtunën e javës që lamë pas përfundoi takimi disaditor i G7-ës, ku ministrat e Punëve të Jashtme të Kanadasë, Francës, Gjermanisë, Italisë, Japonisë, Britanisë së Madhe e Shteteve të Bashkuara dhe Përfaqësuesit të Lartë të BE-së paraqitën qëndrimet e tyre të përbashkëta për Ukrainën dhe disa rajone të tjera në gjithë botën.

Në këtë takim, ku u diskutua për të ardhmen evropiane, u tha se paqja dhe stabiliteti në Evropë vazhdojnë të mbesin të kërcënuara nga Rusia, prej kur kjo e fundit i shpalli luftë shtetit të Ukrainës dhe sot e tre muaj pas, po vazhdon të kryejë gjenocid mbi popullin e saj të pafajshëm.

Me të nisur agresioni rus në Ukrainë, SHBA dhe shtetet e BE-së kanë vendosur sanksione ndaj Ruisë dhe të njëjtën gjë e kanë kërkuar ta bëjnë edhe shtete të tjera.

Republika e Kosovës është ndër shtetet e para të Ballkanit Perëndimor, e cila u rreshtua karshi qëndrimeve të SHBA-së dhe BE-së për vendosjen e sanksioneve ndaj Ruisë. Një ditë pas shpalljes së luftës nga Rusia në Ukrainë, Qeveria e Kosovës, duke qenë e rreshtuar me botën demokratike vendosi sanksione ekonomike dhe financiare ndaj Federatës Ruse, e cila pos që nisi një luftë në Ukrainë, kësaj të fundit i cenoj rëndë sovraniteti dhe integritetin territorial, duke sulmuar paqen, prosperitetin, sigurinë dhe stabilitetin në Evropë.

Të njëjtin qëndrim e kanë mbajtur edhe disa shtete të Ballkanit Perëndimor, qëndrime këto që u mirëpritën nga BE-ja dhe u përshëndetën nga përfaqësuesit e G7-së përgëzuan Kosovën, Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe së fundi edhe Bosnjën për përafrimin e plotë të politikave të tyre të jashtme me BE-në për vendosjen e sanksioneve ndaj Ruisë dhe zbatimin e tyre.

Por, të njëjtën gjë nuk e ka bërë Serbia. Ky shtet vazhdon të mbetet i vetmi shtet i Ballkanit Perëndimor që nuk e ka ndjekur shembullin e SHBA-së dhe BE-së.

Për qëndrimin e njëanshëm të Serbisë pro Ruisë u hodhën kritika dhe akuza nga G7 që po mbajnë anën e agresorit që po kryen gjenocid mbi një popull dhe po rrezikon seriozisht sigurinë në Evropë dhe jo vetëm.

Me këtë qëndrim prorus, Serbia, shteti që para dy dekadash kreu gjenocid mbi popullin shqiptar, tregoi edhe një herë fytyrën e vërtetë të saj. Po pretendon të luajë rolin e viktimës pa dhënë kurrë llogari për dhjetëra-mijëra viktimash shqiptare që u vranë e u masakruan në luftën e fundit në Kosovë si dhe për qindra e mijëra viktima të tjerë që i shkaktoi Ballkanit si pasojë e gjenocidit, krimeve të luftës, sulmeve dhe dëmeve të bëra përgjatë viteve të '90-ta.

G7 u bëri thirrje shteteve të rajonit që të avancojnë reformat e brendshme, në veçanti ato të sundimit të ligjit, të përmirësojnë mjedisin për shoqërinë civile dhe mediat e pavarura, të vazhdojnë përpjekjet për parandalimin e dhunës, të mbështesin pajtueshmërinë dhe të luftojnë dezinformimin mbi gjenocidin dhe glorifikimin e krimeve të luftës dhe dënimin e kriminelëve të saj.

Ministrat e G7-tës po ashtu thanë se e mbështetin bashkëpunimin rajonal dhe tranzicionin energjetik në Ballkanin Perëndimor, veçmas të tregut të përbashkët rajonal dhe të agjendës së gjelbër për Ballkanin Perëndimor në kuadër të kornizës së procesit të Berlinit.

Republika e Kosovës po tregon përkushtim të vazhdueshëm në avancimin e këtyre reformave dhe këtij bashkëpunimi, në mënyrë që përafrimi me shtëpinë e madhe evropiane të jetë më i sigurt se asnjëherë më parë.

G7 e ka thënë prerë se nuk do të tolerojë asnjë formë të përpjekjeve separatiste në Bosnjë e Hercegovinë, duke e bërë të qartë kundërshtinë e plotë me çfarëdo që po vepron Dodik dhe Vuçiq.

Asnjëherë si tani dhe asnjëherë më parë në këto 10 vjetët e fundit nuk ka qenë më e qartë situata në Ballkan, as vendet e G7-tës nuk kanë qenë ndonjëherë më të qartë dhe më të prerë se këtë herë në raport me Serbinë dhe Republikën Serbe në Bosnjë, ku kanë bërë thirrje për reflektim në mënyrë që të ndalohen konfliktet e mundshme në Ballkan. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Nga Partia Demokratike e Kosovës, në emër të deputetit e merr fjalën Isak Shabani.

**ISAK SHABANI:** E nderuar kryesuese,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Dje Kosova ishte në pritje të vendimit të Gjykatës në Hagë për rastin e Nasim Haradinajt dhe Hysni Ngucatit. Ndonëse 90% të popullsisë këtë gjykatë e njohin si gjykatë të imponuar, të dhunshëm ndaj popullit tonë, sepse kjo gjykatë është ndërtuar mbi të dhëna të fabrikuara të Dick Martyt, mbi dëshmi të rrejshme, mbi shpifje të organeve serbe dhe bashkëpunëtorëve të saj.

Për të shpëtuar Kosovën nga këto akuza absurde deputetët e Kuvendit të Kosovës, si dhe udhëheqësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, në bazë të kërkesave të shteteve demokratike e përkrahu themelimin e kësaj gjykate me të vetmin qëllim që të largohen ato re të zeza nga qielli i Kosovës dhe atë me çmimin e sakrifikimit edhe të vetvetes.

Liria është e fituar me sakrificë dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka bërë luftë të drejtë përballë një pushtimi të pamëshirshëm, i cili ka bërë përpjekje për të zhdukur ekzistencën tonë. Kjo gjykatë është e padrejtë, sepse është selektive dhe ekskluzivisht është duke u marrë me shqiptarët, të cilët ishin viktimat të gjenocidit serb, duke mos hetuar asnjë krim dhe gjenocid të bërë kundër shqiptarëve.

Lind pyetja, pse nuk po gjykohen kriminelët për krime të bëra në Prekaz, Reçak, Mejë, Dyz, Qyshk, Makovc, Arbëri, Izbicë, krimet ndaj familjes Ahmeti, Deliu, Bogujevci, Duriqi, Jakupi? Ku mbeti mos ndriçimi i krimit të të burgosurve në Dubravë, i cili ishte krim institucional i kryer nga regjimi serb? Pse nuk trajtohet ky krim, kur sot jemi mbi 800 dëshmitarë të gjallë të kësaj masakre, ku edhe vetë jam i mbijetuar i kësaj masakre.

Gjykata e Hagës shqiptoi dje dënimin e Hysni Ngucatit dhe Nasim Haradinajt me tetë vjet burgim. Një shpresë e vogël na mbante deri dje, por gjykata dënoi drejtësinë dhe jo çlirimtarët. Çlirimtarët janë të lirë që nga viti 1999 dhe nuk ka dënim që e mohon lirinë e bartësve të lirisë. Për ironi, dënimi ndaj tyre u shqiptua në emër të popullit të Kosovës, por ju themi se populli i Kosovës është me bijtë e vet, si dhe jemi kundër absurdeve që bartin emrin drejtësi, e në fakt janë padrejtësi.

Ndërkaq, fajësia e tyre, apo faji që u vihet në bahe tashmë është i ditur, se është i sajuar dhe që në vetvete shpërfaq anarki dhe burokraci të vetë gjykatës. Edhe për njerëzit më laikë është ditur se kjo gjykatë në rend të parë do të duhej hetuar se si rrodhën dhe së fundmi si përfunduan dokumentet në zyrat e OVL-së së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lidhur me këtë fakt Ngucati e Haradinaj dëshmuar pafajësinë dhe parregullsitë në këtë gjykatë, madje në mënyrë më të dinjitetshme ata në disa momente ditën që vetë gjykatën ta shndërrojnë në objekt hetimi.

Nasim dhe Hysni sot është e gjitha Kosova, sepse ata nuk kanë bërë asnjë krim. Ne të gjithë mund të na dënoni, por nuk mund të na ndalni dëshirën për ta dashur vendin dhe për ta parë veten krahë për krah me popujt tjerë të lirë. Gjykatësit mund të bëhen sot vegla të porositura dhe me fakte të fabrikuara serbe t'ia vështirësojnë ecjen këtij populli, duke dënuar njerëz të lirisë. Këtë e ka bërë më parë regjimi serb, duke dënuar të burgosur shqiptarë mbi një shekull vite burgim, me qëllimin e vetëm për të ndaluar aspirimin e lirisë.

Këtë nuk e ka arritur atëherë Serbia dhe këtë nuk do ta arrijë askush as sot. Kanë kaluar mbi 700 mijë shqiptarë nëpër tortura të serbëve. Janë vrarë afër 20 mijë shqiptarë, prej tyre janë vrarë 1432 fëmijë dhe janë vrarë me mijëra gra, pleq e plaka dhe është shkatërruar pothuajse tërë Kosova, por ne nuk kemi ndalur e as që do të ndalemi, sepse Kosova është vendlindja jonë, është atdheu ynë.

Dënimi kundër Nasimit dhe Hysniut nuk është një e keqe që u ka ndodhur vetëm atyre. Mbajtja padrejtësisht e liderit të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit, Sali Mustafës, e Pjetër Shalës nuk është padrejtësi e vetme ndaj tyre. Kjo e keqe është kundër Kosovës, sepse pretendimet e Dick Martyt kishin burim Rusinë, Serbinë dhe bashkëpunëtorët e saj. Andaj, nuk duhet edhe shumë për të kuptuar qëllimin e tyre.

Gjykata serbe para një kohe, sikur kjo sot e Tribunalit të Hagës, shqiptonte dënime në emër të popullit. Edhe atëherë dikush ishte në krah të vendimeve të nxjerra nga ato gjykata. Sot e njëjta po përsëritet, fatkeqësisht, e unë pyes sot: A ka mundësi vallë, që historia të përsëritet? Të mjerë janë ata që i gëzohen dënimit të çlirimtarëve.

I dashur Nasim dhe Hysni,  
Ju që keni përjetuar aq shumë luftë,  
Ju që Serbia ju burgosi familjarisht, me babë, motër e vëlla,  
Ju invalidë të luftës,  
Ju në trupin tuaj morët shumë plagë nga plumbat e armikut.  
Ju që dhatë gjakun dhe shëndetin,  
Ju që nuk u trembët e nuk u dorëzuat edhe atëherë kur mbetët në mal pa bukë, pa municion, pa veshmbathje adekuate,  
Ju që nuk ju mposhti, as acari,  
Ju që nuk u frikësuar, as nga spiunët, as nga shpifjet, as nga armiku shumë i armatosur,  
Ju as sot nuk u mposhtët.

Ju sot jeni më të fortë dhe më të pamposhtur. Ju që ndryshuat rrjedhën e historisë, duke e kthyer atë histori, nga historia e humbjeve në histori të fitoreve. Ju jeni krenaria jonë.

Të dashur qytetarë,  
Deputetë të pranishëm,  
Nuk duhet të na ndajnë arsyetimet dhe pikëpamjet e ndryshme, sepse kjo e keqe do të na dëmtojë të gjithëve, sepse e dëmton Kosovën. Të bashkuar kemi fituar miqtë tanë për lirinë e Kosovës, të bashkuar kemi shpallur Pavarësinë. Të bashkuar mund ta mundim edhe këtë të keqe për vendin tonë.

Lirim sa më të shpejtë për çlirimtarët!  
Ju jeni madhështia dhe krenaria e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!  
Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit!

Të nderuar deputetë, kërkoj mirëkuptimin tuaj, për shkak të rëndësisë së fjalimit janë zgjatur më shumë minuta.

Vazhdojmë me Besian Mustafën, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

**BESIAN MUSTAFA:** Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,  
Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Dje Gjykata e Apelit konfirmoi vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë se vendimi i ZRRE-së për shtrenjtimin e tarifave të energjisë elektrike ishte i paligjshëm. Këtë jua kemi thënë në këtu në seanca, në komisione, në debate të hapura e të mbyllura, në studio televizive e kudo. Por, partia në pushtet nuk dëgjonte.

Në fakt, insistonin që tarifat e rrymës të rriteshin, të dyfishoheshin. Pse insistonin? Çka bënë dhe çka planifikuan të bënin me ato 120 milionë euro që i ndanë e i paguan për rrymën? Tash gjithçka duket e qartë. E kanë kapur Bordin dhe menaxhmentin e KEK-ut, e kanë kapur ZRRE-në, duke e shndërruar në departament të Qeverisë dhe njerëzit e lidhur ngushtë me pushtetin, ose siç i quanin në të kaluarën, “oligarkët e lidhur me pushtetin” kanë kompani që tregtojnë me rrymë në Kosovë. Dhe, kështu e mbyllën qarkun.

KEK-u i kapur nga ta, kompanive të lidhura me partitë në pushtet u shiste rrymë lirë natën e nga të njëjtat kompani e blinte po të njëjtën rrymë shumë shtrenjtë ditën. ZRRE-ja e rriti çmimin e rrymës dhe kompanive të partisë në pushtet iu trashën xhepat. Skemë perfekte për të pasuruar kompanitë e partisë në pushtet dhe disa individë të fortë brenda kësaj partie e qytetarëve një grusht hi syve.

Me dhjetëra e dhjetëra herë LDK-ja u ka dhënë sugjerime konkrete se si t’i paraprini menaxhimit të kësaj krize energjetike që po vinte që nga viti i kaluar. Nuk dëgjuan dhe insistuan që t’i rrisin çmimet e rrymës. Tash natyrisht, po e kuptojmë pse. Për t’i trashur xhepat e kompanive të partisë në pushtet.

Kur e gjithë Evropa ka marrë vendimin gjeopolitik, pra jo vetëm ekonomik, dhe po përkrah projektin e largimit nga gazi rus dhe po investon miliarda euro në gazsjellës të rinj, partia në pushtet në Kosovë refuzoi 200 milionë dollarë grant nga Qeveria e Amerikës për të ndërtuar gazsjellësin dhe termocentralin e rrymës me gaz.

Tash është shumë e qartë, sepse po ju konvenon varësia e plotë në thëngjill, ku KEK-u të cilin e kanë kapur, trash xhepat me miliona euro kompanive të partisë në pushtet. E kanë ditur që me projektin amerikan të gazit nuk mund t’i trashin këta xhepa. Natyrisht këtu të mos harrojmë as shkeljen tjetër ligjore në KEK, ku përmes një procesi antiligjor u rekrutuan mbi 130 militantë të partisë në pushtet. Vetëm presioni i madh publik dhe frika nga burgu i detyroi që ta dërgojnë tërë procesin në rivlerësim.

Ka disa javë që po vizitoni disa kompani amerikane me shpresë për t’i bindur të investojnë në Kosovë. A i keni njoftuar ato kompani amerikane se pushteti juaj ua dyfishon çmimin e rrymës brenda natës, edhe atë bile në mënyrë të paligjshme, vetëm për t’i trashur xhepat e disa kompanive të pushtetit. A mendoni që vijnë kompanitë amerikane të investojnë në një shtet ku rryma shtrenjtohet me tarifa joligjore, ambasadorët biznesmenë të lidhur ngushtë me pushtetin



përfitojnë miliona duke blerë nga KEK-u rrymë lirë natën e duke na e shitur shtrenjtë ditën, e pastaj bartin me çanta qindra mijëra euro lart e poshtë Ballkanit.

A mendoni ju që nuk e dinë ato kompani amerikane që keni refuzuar projektin amerikan të gazit? A kaq të mençur ju duket vetja sa mendoni se i mashtroni kompanitë amerikane? A i keni njoftuar kompanitë amerikane që ministrat tuaj e shkelin Kushtetutën, e pastaj Gjykatës Kushtetuese i kërkojnë raportim se si e paskan mare këtë vendim? A i keni njoftuar kompanitë amerikane se ministrat e juaj japin tenderë njëburimor për punë shtesë, natyrisht me proces të jashtëligjshëm për t'u trashur xhepin kompanive të lidhura me pushtetin. A u keni treguar se në Kosovë inflacioni shkon në 11 për qind, çmimet e ushqimeve, rrymës dhe karburanteve janë dyfishuar, e ju as që çani kokën për këtë punë? Në këtë vit e pak sa jeni në pushtet, keni krijuar krizë pas krize. Asnjëra e menaxhuar, secila e arnuar me masa antiligjore.

Vendimi i Gjykatës së Apelit për rritjen e çmimit të rrymës duhet të jetë thirrja e fundit për ju. Kërkojmë që urgjentisht t'u kthehen qytetarëve mjetet që u janë vjedhur këta tre muaj. Të rishikohen menjëherë tarifat e energjisë elektrike. Natyrisht të jenë të ligjshme, aman. Të shkarkohet bordi i ZRRE-së dhe të emërohet një bord që kthen ligjshmërinë në këtë institucion tejet të rëndësishëm.

Fare në fund, po jo nga rëndësi, të jepet llogari, përgjegjësi ligjore e politike. Kërkojmë përgjegjësi ligjore e politike nga të gjithë ata që përkrahën këto tarifa joligjore.

**KRYESUESJA: Faleminderit!**

Vazhdojmë me deputetin Besnik Tahiri nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

A është në emër të grupit? Në emër të grupit, atëherë.

**BESNIK TAHIRI: Faleminderit nënkryetare!**

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Qeveria e Kosovës tash e një vit vazhdon të prodhojë kriza si në nivelin politik, ashtu edhe ekonomik dhe mbi të gjitha vazhdon të krijojë krizë të mirëqenies së qytetarëve të Kosovës dhe t'i varfërojë ata.

Po e fillojmë në radhë të parë me vendimet antikushtetuese dhe antiligjore, të cilat Qeveria i ndërmori më herët dhe për të cilat nuk e dëgjoi në asnjë moment as debatin parlamentar, as kërkesat e opozitës e as kërkesat e drejtpërdrejta tonat të grupit parlamentar.

Vendimi i fundit i Apelit vërteton se kauza jonë, kërkesa jonë për të mos ngritur tarifat, kërkesa jonë ndaj ZRRE-së që të mos veprojë me ngritje të rrymës vërtetoi që ka qenë e saktë dhe e drejtë.

Tani, çka kemi përpara? Kemi një dëm jashtëzakonisht të madh. Kemi ndarë njëqind milionë euro nga buxheti i Kosovës që ka mundur të shkojë në investime kapitale, përderisa i kemi vendosur qytetarët që të paguajnë tarifa me çmime të rrymës për të cilat cent më cent do të duhet t'u kthehen qytetarëve.

Mbi këtë bazë, dëmi shkon e bëhet edhe më i madh. Cili do të jetë veprimi i kthimit të parave te qytetarët dhe cila do të jetë tarifa ligjore kushtetuese që do të vijë më tej?

E dyta, ka të bëjë drejtpërdrejt me mirëqenien e qytetarëve, me Ligjin e pagave, me pagën minimale dhe me Trustin. Ligji i pagave tash e tri herë që është në agjendën legjislative nuk vjen në Kuvend. Nesër ka paralajmërim të grevave për kërkesën e Ligjit të pagave. 81 mijë zyrtarë publikë kërkojnë nga Qeveria që të ketë veprim dhe është një heshtje klasike. Nuk ka asnjë veprim. Nuk ka asnjë shpjegim dhe nuk ka asnjë dritë në fund të tunelit se kur do të vijë ky ligj. Te paga minimale, veprimi i fundit në Kuvend ka treguar se Qeveria nuk synon ta ngrëjë pagën minimale, po në fakt ta stërzgjasë këtë proces dhe, mbi të gjitha, ta lërë sektorin privat pa i marrë njëqind eurot e tyre, të cilat i kanë në dispozicion nga vendimi i fundit i Qeverisë. Asnjë person që punon në sektorin privat nuk ka arritur të marrë pagesën prej njëqind eurosh.

Së fundi, ajo që vazhdon të jetë kërkesë e përbashkët e opozitës dhe që është imperativ i kohës lidhet drejtpërdrejt me Trustin.

Të nderuar deputetë,

Tani as në Kryesi dhe edhe në Komisionin për Buxhet e Financa është bllokuar Trusti. Është tepër me rëndësi që sa më shpejt ky ligj të vijë në Kuvend, të merremi vesh, të votojmë dhe paratë e qytetarëve, të kontributdhënësve të kalojnë te qytetarët. Ju faleminderit!

**KRYESUESJA:** Tani fjalën e ka Fridon Lala në emër të Grupit Multietnik.

**FRIDON LALA:** Faleminderit, e nderuar kryesuese!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në diskutimin tim të parë parlamentar si deputet i Republikës së Kosovës, në prezantimin e programit qeverisës, ndër të tjera kam kërkuar që në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve Qeveria të ketë angazhim maksimal në adresimin institucional të diskriminimit dhe racizmit, po më së pari funksionalizimit dhe pastaj fuqizimit të mekanizmave përkatës, të cilët do të krijojnë infrastrukturën e nevojshme për parandalimin dhe trajtimin e drejtë dhe efektiv të këtyre fenomeneve negative, të cilat për fat të keq akoma po na përcjellin në shumë raste.

Dy ditë më parë, përmes disa pamjeve të shëmtuara televizive na u dëshmuua për të satën herë që diskriminimi e racizmi janë pjesë e përditshmërisë sonë shoqërore. Fëmijë, egjiptianë e ashkali ishin ndarë veçmas për të manifestuar festën e tyre të abetares në një organizim në Komunën e Pejës. Ato pamje janë plagë e rëndë për shoqërinë tonë multietnike të ndërtuar me shumë sakrifica e mund, mbi fundamentet e demokracisë moderne dhe do të ngelen gjatë në mendjet tona.

Shkolla është institucioni më i shenjtë për fëmijët dhe prishja e këtij imazhi do të shkatërronte ëndrrat e gjeneratave të shumta të ardhshme.

Të lejojmë mbjelljen e urrejtjes te fëmijët është krimi më i madh që ne mund të bëjmë si shoqëri. Kosova që duam dhe për të cilën po punojmë nuk ka hapësirë për mësimdhënës që mbjellin urrejtje në mes nesh. Mësuesve u kemi besuar një profesion të shenjtë, atë të edukimit të brezave të ardhshëm dhe figura perfekte që fëmijët kanë për ta nuk guxon të shndërrohet në figurë të një mësuesi ordiner, i cili bën dallime mes tyre.

Pamjet nga Peja tregojnë një realitet të hidhur se si këto komunitete akoma përjashtohen në mesin e shoqërisë sonë. Duhet ta kuptojmë njëherë e përgjithmonë që egjiptianët, si dhe ashkalinjtë dhe romët janë qytetarë të Republikës së Kosovës, atdheu i vetëm i tyre është Kosova, atdhe për të cilin ata kanë kontribuar me shekuj nga ndjenja e përkatësisë ndaj shtetit të Kosovës.

Është obligim shtetëror yni që të ofrojmë të drejta dhe mundësi të barabarta për secilin qytetar dhe në këtë aspekt nuk tolerohet asnjë kompromis apo preferencë selektive.

Në kohë të vështira, komuniteti egjiptian ka dhënë mësues të shquar për vendin, andaj në asnjë rrethanë nuk lejojmë përjashtimin e tyre nga sistemi arsimor sot. Prandaj, i bëj thirrje Ministrisë së Arsimit dhe kolegëve të mi deputetë nga Komisioni për Edukim dhe Arsim që të angazhohen intensivisht në arritjen e sistemit edukativo-arsimor gjithëpërfshirës, ngase fatkeqësisht në sistemin tonë arsimor akoma kemi mësues që bëjnë ndasi etnike, dallime klasore e linçime, përjashtime sociale e edhe i ulin fëmijët e komuniteteve në fund, duke i demotivuar totalisht ata fëmijë për të vijuar mësimet. Ata mësues e kanë vendin gjithkund tjetër pos në shkolla dhe të gjithë ne së bashku duhet të angazhohemi që ata t'i mbajmë sa më larg fëmijëve.

Fëmijët e këtyre komuniteteve gjuhë amtare e kanë gjuhën shqipe dhe festa e abetares është është festë edhe e tyre dhe ata assesi nuk bën të ndahen nga fëmijët e tjerë për ta festuar këtë festë.

Dhe, për fund, në emër timin dhe në emër të kolegëve Bekim Arifi dhe Erxhan Galushi po ashtu e përshëndesim përkrahjen e madhe që kemi marrë nga kolegët tanë deputetë dhe institucione të ndryshme qeveritare për dënimin e këtij rasti, nga se kjo përkrahje masive tregon edhe

fenomenin e racizmit, i cili akoma është i pranishëm në shoqërinë tonë dhe të gjithë së bashku duhet të angazhohemi në mënyrë që sa më shpejt ta eliminojmë. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, i nderuar deputet!

Pajtohem plotësisht në kërkesën në fjalën tënde që e patët në këtë çështje, është me të vërtetë e rëndë dhe duhet të punojmë në këtë drejtim.

Tani fjalën ia jap deputetit Driton Hyseni.

**DRITON HYSENI:** Faleminderit, nënkryetare!

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Ne kemi përpara sfidën më të madhe në 60 vjetët e fundit në fushën e energjisë.

Krizë që ka rënë mbi Evropën dhe idejimi në mes të krizës i një sistemi energjetik që i takon të ardhmes në Kosovë kërkon virtuozyt dhe planifikim të gjithanshëm.

Andaj, dëshiroj të sjell në vëmendje, të nderuar kolegë deputetë, përfundimi me sukses të plotë të negociatave, gjithashtu edhe finalizimin e marrëveshjes kompakt në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe korporatës amerikane Sfidat e Mijëvjeçarit, program i cili përmban dy projekte shumë të rëndësishme për vendin tonë.

Programi Kompakt, i dakorduar me MCC-në peshon 236,7 milionë dollarë dhe e gjithë shuma i dedikohet sektorit të energjisë. Kjo paraqet investimin më të madh të bërë ndonjëherë në Kosovë në këtë sektor që prej kohës së ndërtimit të termocentraleve, të cilat sot i kemi në funksion, e të ndërtuara para 50 vjetëve.

E sjell në vëmendje këtë marrëveshje sepse për grandet e MCC-së është diskutuar shumë në Kuvendin e Kosovës, është diskutuar për nevojën e madhe të investimeve në sektorin e energjisë dhe domosdoshmërinë e diversifikimit të burimeve të energjisë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Me këtë marrëveshje, por edhe me projekte të reja për ndërtim të kapaciteteve shtesë, sidomos në drejtim të zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, Qeveria e Kosovës ka intensifikuar hapat që furnizimi i qëndrueshëm me energji të mos vihet asnjëherë më në rrezik për qytetarët tanë dhe gjeneratat e ardhshme, e rrjedhimisht të bëhet edhe plotësimi i të gjitha nevojave me energji që ka vendi.

Projekti i parë në Programin Kompakt ka të bëjë me ndërtimin e kapaciteteve për akumulim të energjisë prej 340 megavatë orë, në bateri të cilat do të mundësojnë që energjia e prodhuar në një

kohë të caktuar të mund të akumulohet dhe të shfrytëzohet në periudha kur nevojat janë më të mëdha.

Ky projekt paraqet një hap inovativ dhe mundësi për pavarësimin energjetik dhe integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në sistemin tonë energjetik.

Ndërsa projekti i dytë apo projekti tjetër i këtij programi fokusohet në zhvillimin e aftësive punëtore për t'u përshtatur me nevoja në tregun dinamik dhe inovativ si dhe ka synim përfshirjen më të madhe të grave në sektorin e energjisë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Mundësia e akumulimit të energjisë që Projekti Kompakt i ofron direkt ndikon në uljen e nevojës për import të energjisë. Kur kemi parasysh gjithashtu koston e importit të energjisë që kohëve të fundit ka tejkalluar çdo parashikim të mundshëm, duke meritur në nivelin 700 euro për megavat orë, mendoj që rëndësia e këtij projekti të nënshkruar me MCC-në është jashtëzakonisht shumë e madhe, por edhe si vlerë financiare paraqet një nga investimet që tejkallon investimet dhe huaja të bëra brenda harkut kohor njëvjeçar në shumën prej...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: 10 sekonda, i nderuar.

DRITON HYSENI: Andaj, urojmë për implementim të shpejtë të këtij projekti të kësaj marrëveshje, gjithashtu edhe presim me padurim rezultatet e tij. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti në radhë është Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, e nderuar kryesuese,

Të nderuar kolegë deputetë,

Si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe si opozitë në këtë Kuvend kemi qenë të bindur se vendimi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike, i përkrahur nga Zyra e kryeministrit, i përkrahur nga Zyra e Presidencës dhe po ashtu nga Lëvizja Vetëvendosje ka qenë në kundërshtim të plotë me ligjet dhe legjislacionin në fuqi.

Pra, vendimi i parë i Gjykatës Themelore për pezullimin e implementimit të tarifave, i cili nuk u respektua nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike dhe i cili po ashtu i njëjti as që u përmend as nga mazhoranca, as nga të gjithë aktorët, të cilët kishin dhënë komente dhe kontribut për ngritjen e energjisë elektrike nuk duhet të kaloj në heshtje. Mendoj që kjo është një veprë penale e konsumuar, e cila ka dëmtuar rëndë interesin publik, e cila i ka dëmtuar mbi 450 mijë familje në Republikën e Kosovës dhe një veprë e tillë duhet të ndëshkohet penalisht dhe të ndiqet

penalisht nga Prokuroria Speciale e Kosovës, të cilën shpresojmë se do ta bëjnë ditët në vijim pas kallëzimit penal nga Partia Demokratike e Kosovës.

Tash më kemi vendimin final të Gjykatës së Apelit, vendim ky po ashtu i apeluar nga ZRRE-ja dhe me të cilin i kemi dhënë edhe ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike kundërshtimet tona pse masa e përkohshme deri në vendimin meritohet duhet të jetë në fuqi tashmë është në favorin e 450 mijë familjeve në Republikën e Kosovës.

Pra, është lajm i mirë për secilin qytetar në vendin tonë që energjia elektrike në këtë vend nuk do të paguhet me haraçin, të cilin ua kishte vënë Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike qytetarëve në mënyrë të pabazë, të paligjshme. Pra, ky vendim tashmë nuk do të implementohet, do të kemi në fuqi tarifat e vjetra të energjisë elektrike, mbi të cilën do të tarifohen qytetarët e Republikës së Kosovës dhe ajo çka është e rëndësishme besoj që ne si deputetë nuk mund të rrimë duarkryq edhe të heshtim ndaj kësaj situatë.

Ajo që duhet të ndodhë më e pakta, më e vogla është shkarkimi i menjëhershëm i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike, këta njerëz tashmë me një vendim të gjykatës është vërtetuar që janë në proces e sipër për të shkaktuar një dëm jashtëzakonisht të madh financiar.

Pra, ajo që është më e vogla që ne duhet ta bëjmë si Kuvend i Republikës së Kosovës pa dallime partiake, të kërkojmë përmes një rezolute shkarkimin apo të sjellim në Kuvend shkarkimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike.

Pra, këta njerëz i kanë dëmtuar më shumë se 450 mijë familje në Republikën e Kosovës, kjo nuk duhet të tolerohet. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Të nderuar deputetë, ka përfunduar koha e deklaramit jashtë rendit të ditës.

## **2. Pyetjet parlamentare**

Për këtë seancë janë parashtruar 23 pyetje parlamentare. Po së pari do të fillojmë me pyetjet e bartura nga seanca e kaluar. Deputetja Time Kadrijaj ka pyetje për ministrin Rifat Latifi. Deputetja nuk qenka këtu.

Vazhdojmë me pyetjet e radhës. Deputetja Rezarta Krasniqi, pyetje për ministrin Rifat Latifi. Ministrin nuk e kemi këtu, a do ta bësh pyetjen.

**REZARTA KRASNIQI:** Jo, jo! Faleminderit, nënkryetare!

Pasi që ministri nuk është prezent, po e lë për seancën e radhës.

KRYESUESJA: Pyetja e radhës është nga deputetja Mirlinda Sadiku, për ministrin Faton Peci.

E nderuar, ministrin iu desh të largohet për shkak të një agjende, kështu që doni ta shtyni pyetjen për seancën e radhës. Në rregull.

Deputeti Anton Quni, pyetje për zëvendëskryeministren dhe ministren Donika Gërvalla-Schwarz.

ANTON QUNI: Faleminderit, kryesuese!

Është shumë me rëndësi që kjo pyetje të marrë përgjigje nga zonja ministre, zonja Donika Gërvalla, kështu e shfrytëzojmë rastin në seancën e radhës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi, nuk qenka e pranishme në sallë.

Deputetja Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, pyetje për ministrin Liburn Aliu, ministri nuk është këtu, në rregull. E shtyjme edhe këtë pyetje për seancën e radhës.

Deputetja Arjeta Fejza, pyetje për ministrin Hajrullah Çeku, e shtyjme për seancën e radhës.

Gjithashtu kemi edhe nga deputetja Arjeta Rexhepi, e shtyjme për seancën e radhës.

Deputeti Valon Ramadani, pyetje për ministrin Elbert Krasniqi, e kemi ministrin këtu.

VALON RAMADANI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare Bogujevci!

Çështjen që unë do të shtroj për Ministrinë e Administratës dhe Pushtetit Lokal ka të bëjë me një njoftim që e ka publikuar ministria para një muaji. Njoftoj se do të mbështes komunitetet për projektet të komuniteteve me fondin prej një milion euro. Nismë e ndërmarrë për herë të parë në këtë format dhe që synon drejtpërdrejt adresimin e problemeve të mëdha që kanë bashkëqytetarët tanë nga radhët e komunitetit pakicë.

Pra, pyetja është kështu: a ka filluar aplikimi për këtë fond dhe si e ka organizuar MAPL-ja këtë proces?

KRYESUESJA: Para se të marrë fjalën ministri Krasniqi, vetëm dua t'i kërkoj falje deputetes Ariana Musliu-Shoshi, e paskështa ngatërruar renditjen e pyetjes suaj, kështu që me radhë do të ishte. Po ministër, fjala për ty.

MINISTRI ELBERT KRASNIQI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare!

Të nderuar kolegë ministra,

Të dashur deputetë,

I nderuar deputet Ramadani,

Faleminderit shumë për pyetjen?

Ministria e Administratës të Pushtetit Lokal në kuadër të programeve për financimin e komunave ka edhe këtë program të ri që është program i financimit të projekteve infrastrukturore për komunitetet në komunat e Republikës së Kosovës.

Ne kemi hapur një thirrje para tri javësh, thirrja është mbyllur, ka përfunduar edhe procesi i parë i kontrollit administrativ, mund t'ju informoj që nga 38 komuna të Republikës së Kosovës kanë aplikuar 20 komuna me 39 projekte dhe gjatë kësaj jave do të bëhet përzgjedhja e projekteve, të cilat do të financohen nga ky kod buxhetor për komunat e Republikës së Kosovës.

Është shumë e rëndësishme që të specifikohet që kjo u jep mundësi që të financohen komunitetet e zonave ku jetojnë me këto projekte. Për shembull, një komunë me shumicë shqiptare mund të aplikojë vetëm për projekte infrastrukturore për zonat ku jetojnë komunitetet ose një komunë me shumicë serbe mund të aplikojë vetëm me projektet të cilat financojnë projekte të komuniteteve pakicë në atë territor.

Është një program shumë i mirë, për shkak se u jep mundësi edhe zonave që kanë qenë të lëna anash për një kohë shumë të gjatë që të përfshihen në planin komunal të financimit të projekteve. Bashkëfinancohet me komuna, do të thotë është 10% bashkëfinancimi i komunave, përpos një milion euro nga buxheti i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, do të bashkëfinancohet edhe me 10% nga komunat e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: A keni pyetje shtesë? Jo, në rregull!

Deputetja Ariana Musliu-Shoshi, pyetje për zëvendëskryeministren e ministren Donika Gërvalla-Schwarz.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, nënkryetare!

Pasi që ministrja nuk është këtu, do ta bart pyetjen time për seancën e radhës.

KRYESUESJA: Në rregull, faleminderit! Deputeti Besim Muzaqi, pyetje për ministrin Elbert Kransiqi.

BESIM MUZAQI: Faleminderit, kryesuese!

I nderuar ministër Krasniqi,

Ju keni formuar Task-forcën për zgjedhjen e problemit me qentë endacakë. Pasi rastet dhe shqetësimet e qytetarëve prej kryeqytetit deri në qytetet më të vogla janë në rritje dhe pasojat po bëhen gjithnjë e më të mëdha, secili nga ne është me sytë nga ju gjegjësisht nga niveli qendror.



Jemi të vetëdijshëm që komunat në përgjithësi dhe në veçanti Komuna e Prishtinës nuk e kanë organizimin e nevojshëm dhe as zgjidhje konkrete si ta adresojnë këtë çështje.

Të gjithë presim që kjo problematikë të zgjidhet nga niveli qendror sa më parë dhe me sa më shumë efikasitet.

Pyetja ime është: Deri ku ka arritur puna me Task-forcën për problemin me qentë endacakë, kur pritet finalizimi dhe zgjidhjet konkrete, vlerësimi financiar dhe kush do ta zbatojë këtë vlerësim të paraqitur.

KRYESUESJA: Ministri Krasniqi e ka fjalën.

MINISTRI ELBERT KRASNIQI: Faleminderit për pyetjen!

Ky është një nga shqetësimet kryesore këto ditët e fundit, mirëpo edhe një shqetësim që e ka pasur një histori edhe para ditëve të fundit. Qytetarët e kanë shqetësim problematikën e qenve endacakë. Ne si Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kemi nxjerrë një vendim më datën 16 shkurt të këtij viti që të formohet një grup punues për hartimin e strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për menaxhimin dhe kontrollin e qenve me dhe pa pronarë.

Strategjia është hartuar në bazë të analizës së gjendjes aktuale të qenve endacakë dhe bazuar në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës. Nga shkurti i këtij viti grupi punues ka mbajtur tri takime dhe tri punëtori, strategjia është në finalizim. Ndërsa më 30 dhe 31 maj do të finalizohet edhe plani i veprimit.

Pasi të përfundojnë që të dyja do t'i dërgojmë fillimisht në komuna për komente dhe pastaj me konsultime publike.

Strategjia parasheh që të përfundohet me të gjitha procedurat sipas Udhëzimit administrativ për hartimin dhe planifikimin të strategjive më së largu deri në fund të qershorit. Në fund të qershorit do ta kemi të adoptuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës strategjinë nacionale për qentë endacakë dhe qentë me pronarë dhe pa pronarë.

KRYESUESJA: Kemi, dy pyetje për ministren Nagavci. Ministrja më njoftoi që shumë shpejt do të jetë e pranishme në seancë, kështu që nëse doni të prisni derisa të kemi ministren këtu, vazhdojmë me pyetje të tjera. Në rregull.

Deputeti Salih Zyba, pyetje për ministrin Faton Peci.

SALIH ZYBA: Ministri nëse është prezent, e kisha shtruar pyetjen.

KRYESUESJA: Jo ministrit siç ju njoftova më herët iu desh të largohet, meqë e kishte një obligim.

SALIH ZYBA: Atëherë do të kem mundësi në seancën e radhës, të lutem!

KRYESUESJA: Në rregull! Në radhë është deputeti Enver Haliti, pyetje për ministren Artane Rizvanolli.

ENVER HALITI: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar ministra,

Pyetja ka të bëjë me ministren e Ekonomisë, zonjën Artane Rizvanolli.

E nderuar ministre, javën e kaluar ju dhe kryeministri Kurti njoftuat nënshkrimin e marrëveshjes Kompakt me Agjencinë Qeveritare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ‘Milenium Challenge Corporation’, po ashtu dhe procesi i negocimit për këtë marrëveshje.

Kjo marrëveshje është orientuar në sektorin e energjisë, marrë parasysh diskutime të shumta publike lidhur me këtë çështje dhe po ashtu me shumën mjaft të madhe prej 236 milionë dollarëve pritet nga ju të sqaroni hollësitë e këtij projekti për deputetët dhe qytetarët e vendit.

Çfarë do të përmbajë konkretisht kjo marrëveshje 236 milionë dollarësh në fushën e energjetikës dhe çfarë do të ndryshojë konkretisht në Kosovës pasi kjo marrëveshje të jetë zbatuar plotësisht? Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit z. Glauk Konjufca.)*

KRYETARI: Ministrja Rizvanolli përgjigjet.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Ju faleminderit për pyetjen, i nderuar deputet Haliti!

Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,

Sipas marrëveshjes së negociuar me MCC-në gjatë javës së kaluar është propozuar një Program Kompakt, i cili është në vlerë prej 202 milionë e 36 mijë e 670 dollarë. Sipas marrëveshjes së negociuar kompakti i propozuar do të financohet në masë 202 milionë dollarë amerikanë nga MCC-ja, ndërsa pjesa tjetër do të bashkëfinancohet nga Qeveria e Kosovës.

Qeveria e ka përgjegjësinë kryesore për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e zbatimit të programit, me një pëlqim paraprak të MCC-së, Qeveria do të caktojë një entitet, i cili do të themelohet si entitet autonom në përputhje me ligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare, i cili subjekt do të jetë përgjegjës për zbatimin e programit dhe për të ushtruar të drejtën e detyrimit të

Qeverisë për të mbikëqyrur, menaxhuar dhe zbatuar programin, duke përfshirë pa kufizim në menaxhimin e zbatimit të projekteve dhe aktiviteteve të tyre.

Objektivi i parë i programit është ruajtja e energjisë që do të mbështetë sigurinë e energjetike të Kosovës dhe tranzicionin në një të ardhme më të pastër të energjisë.

Brenda këtij projekti janë disa aktivitete, aktiviteti për rregullimin e frekuencës që synon të mbështesë KOST-in që është përgjegjës për planifikim, zhvillim, mirëmbajtje dhe operim të sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë.

KOST-i do të mbështetet për të zotëruar dhe operuar përafërsisht 45 megavatë kapacitet, për të cilat do të sigurojnë 90 megavatë orë të rezervave të energjisë. Ky projekt zbut disbalancat në rrjetin elektrik, duke garantuar sigurinë e sistemit energjetik dhe duke mundësuar njëkohësisht integrimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Aktiviteti tjetër është ai i ruajtjes së energjisë që synon operimin e 125 megavatëve për rezerva 250 megavatë orë të një ose më shumë sistemeve të baterive ose sisteme të tjera potenciale të ruajtjes së energjisë.

Sistemet e baterive do të projektohen për të mundësuar rezervat e rivendosjes së frekuencës, arbitrazhin e energjisë ose shërbime të tjera potenciale të ruajtjes së energjisë.

Përveç kësaj, është aktiviteti për mbështetjen e politikave të energjisë dhe klimës që do të sigurojë që ruajtja e energjisë është e përcaktuar dhe rregulluar mirë përmes ligjeve të Kosovës dhe mbështetur nga planifikimi i mirë, mirëmbajtja e tyre dhe realizimi i plotë i projektit në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative relevante.

Ky aktivitet gjithashtu përfshinë masa ndërsektoriale për ta promovuar përfshirjen e grave...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Zgjatjani fjalën një minutë ministres që ta shpjegojë projektin.

**MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI:** Faleminderit, shumë!

Projekti tjetër brenda këtij Programi të propozuar Kompakt është projekti Jeta, projekti i tranzicionit të drejtë energjetik, i cili synon të arrijë pjesëmarrje të barabartë gjinore në trajnime përmes përpjekjeve të bashkërenduara dhe gjithëpërfshirëse.

Programet e trajnimit do të fokusohen në nivelin passekondar, parauniversitar, do të thotë nivelet katër dhe pesë të kornizës së kualifikimeve të Bashkimit Evropian, mirëpo gjithashtu mund të përfshijë edhe nivele të tjera të trajnimit.

Synimi kryesor është që në radhë të parë të ngritën shkathtësitë e fuqisë punëtore në përputhje me kërkesat e tregut të energjisë dhe sektorit të energjisë që është mjaft dinamik dhe inovativ dhe, nga ana tjetër, të sigurohemi gjithashtu që përfshirja e grave si në zhvillim të shkathtësive, ashtu edhe në punësim në këtë sektor të ngritët gjatë viteve në vijim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Deputeti Haliti, a ke pyetje shtesë? Jo!

Mirë, këtu e kemi tash deputeten Time Kadrijaj, e cila e ka një pyetje të bartur prej seancës së kaluar, pyetja i drejtohet ministrit Rifat Latifi. Po me sa po e shoh, ministri nuk qenka këtu.

**TIME KADRIJAJ:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Ministri po e shoh që nuk është këtu, po është një çështje tepër e rëndësishme. Gjatë kontakteve të vazhdueshme që kemi pasur me qytetarët e Kosovës, të gjithë kanë ankese që për të marrë shërbime në Qendrën Klinike Universitare listat e pritjes janë mjaft të gjata gati në të gjitha shërbimet.

Si po komunikon ministri me strukturat udhëheqëse të Qendrës Klinike Universitare dhe çka e ka ndërmend të bëjë që këto lista të pritjes të zvogëlohen, sepse në të kaluarën, për shembull, në kardiologji dhe kardiologji invazive listat e pritjes kanë ra aq shumë sa qytetarët brenda një jave, dy jave kanë mund të marrin shërbime, ndërsa tash duhet të presin për gjashtë, shtatë muaj dhe në rast se pacientët kanë urgjencë të marrin së këtyre trajtimeve, shpesh ndodh që ata vdesin para se t'u vijë rendi të marrin një trajtim.

Andaj, duhet të trajtohet me seriozitet dhe ministri duhet t'i takojë të gjithë shefat e klinikave, të gjithë drejtorët e klinikave, në mënyrë që të shihet çka dhe ku po ka ngecje në marrjen sa më të shpejtë të shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ministri e ka mundësinë që t'ju përgjigjet edhe me shkrim, natyrisht, dhe shpresojmë që edhe ta bëjë.

Tash e kemi këtu ministren e Arsimit. Kështu që ia japim fjalën deputetit Jahja Kokaj, ia drejton një pyetje asaj.

**JAHJA KOKAJ:** Faleminderit, zoti kryetar!

Ministra,  
Qytetarë të nderuar,  
Kolegë deputetë,

Meqë çështja për të cilën duhet të pyes konsideroj është me rëndësi të veçantë, kam dëshirë që të sensibilizoj situatën e punësimit të disa të rinjve përkatësisht të ripërtëritjes së fuqive trunore, pra të trurit të ri dhe lidhur me këtë është fakt që Ministria e Arsimit ka planifikuar që të përfshihen 300 asistentë të rinj në shkollat e vendit tonë.

E nderuar zonjë ministre, a ka mundësi që në mënyrë koncize dhe eksplicite të na informoni se ku ka arritur ky proces, në çfarë faze është?

Kam dëshirë që përgjigja të jetë eksplicite, koncize dhe mundësisht e shoqëruar në mënyrë kuantitative, pra me shifra. Faleminderit!

**KRYETARI:** Urdhëroni, ministre!

**MINISTRJA ARBËRIE NAG AVCI:** Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Deputet Jahja Kokaj, faleminderit për pyetjen!

Po mundohem të përgjigjem shkurt dhe saktë.

Sikurse edhe e përmendët, ne kemi planifikuar në buxhetin e vitit 2023 punësimin edhe të 300 asistentëve. Gjatë këtij viti janë buxhetuar dhe janë në finalizim të punësimit njëqind asistentë të fëmijëve me nevoja të veçanta. Domethënë, premtimin që të kemi së paku 500 asistentë gjatë mandatit qeverisës në institucionet tona edukativo arsimore po synojmë ta arrijmë që në vitin e ardhshëm 2023.

Aktualisht, sa u përket këtyre njëqind asistentëve që janë duke u punësuar në komuna, në shumicën e komunave ka përfunduar procesi. Së fundmi, në Prishtinë janë rekrutuar pesëmbëdhjetë asistentë, në disa komuna të tjera pak më herët. Ndërsa, ka pasur dy komuna që kanë pasur sfida në lidhje me gjetjen e kuadrove të kualifikuara me profilin që kërkohet për asistentë të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Në raport me përgatitjet për vitin e ardhshëm 2023, si Ministri e Arsimit i kemi hartuar kriteret për përcaktimin e numrit të asistentëve në komuna të ndryshme, pra secilës komunë nga sa asistentë do t'i takojnë, dhe kjo është bërë sipas numrit të banorëve nëpër komuna, fëmijëve të identifikuar që kanë nevojë për të pasur asistent në përcjelljen gjatë mësimin të tyre të rregullt dhe analizës nga vizitat e zyrtarëve nëpër komuna lidhur me nevojat që kanë komunat për asistentë, pra varësisht prej numrit të tyre.

Është bërë përcaktimi për komuna të caktuara dhe paralelisht me këtë kemi duke punuar edhe në përgatitjen e kuadrit të kualifikuar. Ministria tashmë ka një program në bashkëpunim me PIRSON, që ofron mbështetjen për asistentët dhe gjatë muajit në vijim do të shpallet konkursi për së paku tri qendra, në mënyrë që t'u ofrohet mundësia edhe të rinjve në qendrat që janë afër, sipas rajoneve, për të vijuar programin dhe të kemi kuadrin e nevojshëm për vitin e ardhshëm.

Shpresoj që ju jam përgjigjur me të dhëna.

Programi i kualifikimit do të realizohet në bashkëpunim me Agjencinë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin e të Rriturve me PIRSO-n, sikurse e përmenda, dhe grupet do të formohen në katër qendra rajonale në Kosovë, në mënyrë që të kemi kuadro nga të gjitha komunat, të mos kemi raste si në komunën e Gjilanit, për shembull, ku këtë vit nuk arritën të punësojnë asistentin për shkaka të mungesës së kuadrit të kualifikuar.

Përpos kësaj, jemi duke i shqyrtuar të gjitha mundësitë që në kuadrin e këtyre treqind të punësuarve të kemi edhe profile të tjera, përpos këtij profili që ofrohet me programin PIRSO, po të kemi edhe kuadro...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Ia shtoni edhe një minutë ministres për t'u përgjigjur.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Pra, do të kemi edhe profile të tjera, si punëtorë socialë, pastaj logopedë, pedagogë, varësisht prej nevojave që identifikohen në bashkëpunim me komunat.

KRYETARI: Deputeti Kokaj, a keni pyetje shtesë për ministren? Urdhëro!

JAHJA KOKAJ: Faleminderit! Përgjigjja përshkruan një aktivitet mjaft impresiv dhe një dinamikë ashtu siç kërkohet. Jam shumë i lumtur që planifikohet një realizim deri te numri 500. Dëshiroj që të jetë edhe më i madh, por ne jemi këtu deputetë që të përcjellim mirëvajtjen e kësaj çështjeje. Faleminderit për përgjigjen!

KRYETARI: Faleminderit! Tash deputetja Adriana Matoshi e ka një pyetje për ministren Arbërie Nagavci, po ashtu. Urdhëroni, deputete!

ADRIANA MATOSHI: Faleminderit, kryetar!

E nderuar ministre,

Prej vitesh janë cituar emra projektesh dhe bashkëpunimesh lidhur me orientimin në karrierë të nxënësve tanë në të gjitha ciklet. Me gjithë përmirësimet në disa drejtime, siç jemi të gjithë në dijeni, në vendin tonë mungon orientimi në karrierë në kohën e duhur gjatë studimeve shkollore.

Duke qenë se plani qeveritar parashikon forcimin e shkollimit profesional dhe orientimin drejt tij në karrierë të nxënësve, bëhet i domosdoshëm.

Pyetja është kjo, zonja ministre: A keni në plan dhe nëse po, kur do ta filloni programin e orientimit në karrierë në të gjitha shkollat e vendit, prej klasave të ulëta, pra para se të zgjedhin drejtimin për shkollimin e mesëm? Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, ministre!

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

E nderuar deputete, faleminderit për pyetjen!

Vetëm ju njoftoj se ardhja ime me pak minuta vonesë këtu ishte për shkak se në bashkëpunim me Zyrën Zvicerane dhe përfaqësues, kryetarë e përfaqësues nga tetë komuna, sapo nënshkruam një marrëveshje për hapjen e tetë qendrave të reja për orientimin në karrierë në tetë komuna të ndryshme.

Përtej kësaj, në përgjithësi ju njoftoj se në plan-programet aktuale orientimi për karrierë është i përfshirë në kuadër të programeve lëndore, por është e vërtetë që praktika ka treguar se megjithatë të rinjve dhe fëmijëve tanë u mungon orientimi, gjegjësisht informatat e mjaftueshme, të nevojshme, për orientimin në karrierë, përkundër që përveç përfshirjes në programet lëndore ka edhe aktivitete, siç janë për shembull, organizimi i javës së dyerve të hapura me vizita në shkolla, ku nxënësit marrin informata për profilet e mundshme të studimit të tyre, për biznese, programe të ndryshme, për punën praktike, punësimin, e kështu me radhë.

Megjithatë, të vetëdijshëm që po ballafaqohemi me këto sfida, sa i përket mbështetjes profesionale të nxënësve lidhur me orientimin dhe këshillimin në karrierë, kjo është një nga prioritetet tona. Pas monitorimit edhe të implementimit të kurrikulës dhe rezultateve konkrete, ne në bashkëpunim edhe me ekspertë vendorë e ndërkombëtarë në fund të marsit me mbështetje të GIZ-it gjerman kemi filluar hartimin e koncept-modelit të ofrimit të orientimit në karrierë edhe për nxënësit e klasave nga e gjashta deri në klasën e nëntë, pra që të fillojmë orientimin në karrierë që nga shkolla e mesme e ulët, përveç mbështetjes që jepet në shkollën e mesme të lartë, gjegjësisht në shkollat e mesme profesionale kryesisht.

Në këtë linjë dhe për këtë prioritet për vitin e ardhshëm, për vitin 2023, tashmë veçse kemi planifikuar buxhetin për punësimin e këshilltarëve të karrierës në shkollat e mesme të ulëta, pra nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë, dhe kemi planifikuar që të sigurojmë së paku një këshilltar në karrierë për pesëqind nxënës të moshës 11 -14 vjeç.

Pra, aktualisht jemi duke ofruar orientimin në karrierë në shkolla të mesme, por nga viti 2023 do të ofrojmë këto këshillime nëpërmes këshilltarëve të karrierës edhe për nxënësit, gjegjësisht fëmijët tanë nga mosha 11 - 14 vjeç. Buxheti është planifikuar dhe jemi në finalizim të koncept-dokumentit për profilet dhe kualifikimet adekuate për të ofruar këto shërbime. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, a keni pyetje shtesë? Jo!

Tash kalojmë te deputetja Fjolla Ujkani, ia drejton një pyetje ministrit Liburn Aliu, i cili nuk është këtu. E shtyjme pyetjen, deputete? Po!

Deputeti Visar Korenica.

VISAR KORENICA: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse, ministri nuk është këtu, atëherë po e kaloj pyetjen për seancën e radhës.

KRYETARI: Po ashtu, një pyetje për ministren Nagavci e ka deputetja Arijeta Rexhepi.

ARIJETA REXHEPI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Në programin qeverisës është paraqitur si projekt me prioritet mësimi dual dhe zbatimi i tij në kushtet e Kosovës. Marrë parasysh referencat e shpeshta në boshllëkun e evidentuar të shkathtësive të të rinjve tanë në profesione të shumta, gjithnjë e më shumë ka mangësi dhe kërkesë nga sipërmarrësit prodhues të Kosovës, krijimi i programeve të mësimi dual është gjithnjë e më shumë emergjencë e përgjithshme, veçanërisht referuar sektorëve prodhues të industrisë së lehtë dhe asaj ushqimore.

E nderuar ministre, kur do të kemi rezultatin e parë konkret me programin dual të mësimi në Kosovë dhe çfarë është duke ndodhur aktualisht me përgatitjet e ministrisë në këtë drejtim?

KRYETARI: Ministrja Nagavci përgjigjet. Urdhëroni!

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetar!

E nderuar deputete Rexhepi, faleminderit për pyetjen!

Sikurse e përmendët, arsimit profesional është një nga prioritetet e Qeverisë sonë dhe në këtë linjë të vetëdijshëm për rëndësinë e arsimit dual për ekonominë e vendit dhe të ardhmen e të rinjve tanë, si dhe domosdoshmërinë e fuqizimit të bashkëpunimit në mes të ministrive të linjës dhe bartësve kryesorë për inicimin e arsimit dual, kemi ndërmarrë një serë aktivitete në këtë drejtim.

Fillimisht vlen të përmendet që në nivel të kryeministrit kemi themeluar Komisionin Ekzekutiv për Arsimin dhe Aftësimin Profesional për përshtatjen e arsimit aftësimi profesional me nevojat e tregut të punës dhe ky komision udhëhiqet nga vetë kryeministri Kurti. Në kuadër të kësaj është marrë vendim edhe për themelimin e task-forcës, që merret me inicimin e zbatimit dhe arsimit dual, si dhe me fuqizimin e Odës Ekonomike të Kosovës në bashkëpunim me MINT-in,



të cilat njëkohësisht punohet edhe në rishikimin e Ligjit të punës dhe definimin e insentivave për bizneset që do të involvohen në implementimin e arsimit dual.

Përpos kësaj, kemi nënshkruar tashmë një marrëveshje me Fondacionin Besa me biznesmenë të suksesshëm nga mërgata jonë dhe ky fondacion është duke ndihmuar ministrinë në promovimin e arsimit dual drejt ndërmarrjeve dhe komunitetit të prindërve dhe të nxënësve, që të sigurojnë të gjitha dokumentet e nevojshme nga Gjermania për të ofruar edhe në kontekstin e Kosovës këtë model të mësimi, i cili është i suksesshëm në vendet gjermanofolëse dhe, po ashtu jemi duke punuar edhe në përgatitjen e instruktorëve që do të ofrojnë shërbimet e tyre gjatë organizimit të mësimi dual.

Si një pilotim, ashtu të themi, një test të kësaj, fillimisht në prill të këtij viti, me ndihmën e Fondacionit Besa është vendosur që tridhjetë nxënës të klasave të dymbëdhjeta nga profili i muratorit të punojnë në dy kompani, pra të fillojnë praktikën në dy kompani, me një pagesë prej 300 eurosh për secilin prej nxënësve.

Kemi marrë edhe vendimin për të filluar nga viti shkollor i ardhshëm 2022/2023 pilotimin e arsimit dual në tri-katër profile gjatë vitit të ardhshëm shkollor. Profilet ku do të ofrohet pilotimi i mësimi dual, gjegjësisht ku do të fillojë të implementohet ky mësim, janë profilet ku bizneset tona janë të suksesshme, siç janë profilet e përpunimit të drurit, metalpunuesve, gastronomi dhe floktari.

Aktualisht jemi duke identifikuar bizneset, kompanitë, ndërmarrjet, të cilat janë të interesuara të marrin pjesë në ofrimin e arsimit dual, si dhe janë duke i mbajtur diskutimet me sektorë të tjerë, në mënyrë që të definojnë të gjitha specifikat, ashtu që fëmijët tanë të kenë një implementim të suksesshëm të mësimi dual.

**KRYETARI:** Deputete Rexhepi, a keni pyetje shtesë?

Vazhdojmë me pyetje të tjera. Tash, deputeti Enver Dugolli ia drejton një pyetje ministres Albulena Haxhiu, por nuk e kemi ministren këtu.

Urdhëro, deputet Dugolli!

**ENVER DUGOLLI:** Faleminderit, kryetar!

Meqë ministrja ka lajmëruar me kohë se është në një takim të rëndësishëm me Komisionin e Venecias, unë po e lexoj pyetjen, për shkak se pres përgjigje zyrtare për këtë pyetje.

I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk ka muaj apo ditë në kalendarin e vitit, e sidomos në stinën e verës, kur shqiptarët e Kosovës nuk përkujtojnë me dhembje të madhe përvjetorë të shumtë të masakrave gjenocidale që Serbia ka kryer ndaj popullatës civile në Kosovë gjatë luftës së fundit të zhvilluar më 1998-1999.

Edhe pse në parimet e së drejtës penale thuhet se krimet nuk parashkruhen, apo nuk vjetrohen, dhe si të tilla mund të gjykohen në cilëndo kohë të mundshme, ne jemi dëshmitarë se shumë kriminelë që kanë kryer këto krime ende shëtisin të lirë në Serbi, madje mbajnë poste të larta në institucionet e Serbisë, sepse drejtësia nuk po vepron.

Në anën tjetër, edhe pse është miratuar Kodi Penal për dënimin e kriminelëve në mungesë, institucionet tona të drejtësisë, siç është Prokuroria e Shtetit, i kanë “futur veshët në lesh”, duke mos treguar qasje serioze për fillimin e hetimeve dhe gjykimin e kriminelëve të luftës, qoftë edhe në mungesë.

Prandaj, pyetjen e kam kështu: Edhe pse, pushtetet janë të ndara, sa jeni në dijeni për këtë mosveprim të çuditshëm të Prokurorisë?

Dhe së dyti, çka po bën ministria në adresimin e kësaj çështjeje, sepse zonja ministre, siç e dini, edhe pse krimet e luftës nuk parashkruhen, nuk vjetrohen, mirëpo në aspektin e dëshmimit të tyre, apo sa më shumë kohë që kalon, aq më e vështirë është që të dokumentohen dhe të dëshmohen, kur dihet se edhe dëshmitarët plaken, sëmuren, apo edhe mund të vdesin pa e thënë të vërtetën që e kanë përjetuar. Faleminderit!

**KRYETARI:** Presim që përgjigje të japë ministrja, qoftë me shkrim. Deputeti Gramoz Agusholli e ka një pyetje për ministrin e Financave, Hekuran Murati. Ministrin nuk e kemi këtu. Deputet, dëshironi ta bëni pyetjen, apo herën tjetër? Mirë. Dhe, Driton Hyseni tash, pyetje për ministrin Artane Rizvanolli. Ministrja është këtu. Urdhëro, deputet Hyseni!

**DRITON HYSENI:** Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, për qytetarët e vendit!

Ministre Rizvanolli,

Keni prezantuar publikisht një projekt jashtëzakonisht të madh, që quhet “Solar for Kosovo”, i cili pritet të jetë një nga termocentralet më të mëdha diellore në Evropë dhe pritet të shtojë kapacitetet me rreth 70 MW në sistemin e ngrohjes në Prishtinë.

Kështu me këtë projekt ju e keni prezantuar informacionin se nga ky termocentral përfitojnë rreth 12 000 familje, apo kalkuluar në numër të banorëve, rreth gjashtëdhjetë mijë qytetarë të kryeqytetit të Republikës.

Po ashtu, se ky termocentral do të ndërtojë kolektorë diellorë me një sipërfaqe prej përafërsisht 69 000 metra katrorë. Marrë parasysh situatën energjetike të krijuar në Evropë në gjysmën e dytë të vitit 2021, por gjithashtu edhe tremujorin e parë të vitit 2022, ky projekt mendoj që ka një fokus jashtëzakonisht jetik për vendin tonë, sepse duhet të orientohemi shumë te mundësitë e prodhimit të energjisë në kapacitetet vendore.

Pyetja ime konkrete për ju sot është: kush janë financuesit dhe operuesit e këtij projekti? Sa do të jetë shuma e investimit, por edhe ajo që është shumë e rëndësishme edhe për qytetarët me interes të dinë, se kur do të përfitojnë nga ky projekt? Kur do të përfundojë projekti, pra kur do të jetë i finalizuar dhe qytetarët të kenë mundësi t'i marrin shërbimet nga ky projekt?

**KRYETARI:** Urdhëroni, ministre!

**MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI:** Faleminderit, i nderuar deputet Hyseni për pyetjen! Projekti “Solar for Kosovo” për ngrohjen qendrore në Prishtinë me energji solare, sipas vlerësimit fillestar të studimit të parafizibilitetit të vitit 2019 ka qenë i vlerësuar se do të kushtojë rreth 64 milionë euro dhe fillimisht ka qenë ideja që të bashkëfinancohej nga Banka Zhvillimore Gjermane KFW dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, BERZH-i. Kosto finale e projektit pritet të përditësohet gjatë këtij muaji, në kuadër të finalizimit të studimit të fizibilitetit, i cili është duke u realizuar me grant nga Qeveria gjermane.

Sipas shifrave të studimit të parë është bërë një plan i financimit, si në vijim:

- grant nga Qeveria gjermane, përkatësisht nga KFW-ja do të jepen 31,6 milionë euro,
- 5 milionë euro pritet të jetë kontributi nga Termokosi,
- kemi aplikuar gjithashtu, për një grant investim nga Western Balkans Investments Framworld WBIF, për 15 milionë euro, dhe
- pjesa tjetër është kredi nga BERZH-i.

Me këto shifra që i kemi aktualisht, i bie rreth dymbëdhjetë milionë euro, sipas studimit të parafizibilitetit, domethënë kredi nga BERZH-i.

Sa i përket operimit dhe zbatimit të projektit, Termokosi do të jetë njësi ekzekutive e projektit, që ka përgjegjësi koordinimin e përgjithshëm të projektit, monitorimin dhe administrimin e tij. Ndërsa, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve do të jetë përgjegjëse për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe kanalizimin e tyre te Termokosi.

Sa i përket vitit të finalizimit, planifikohet që projekti të përfundojë në vitin 2025. Faleminderit!

**KRYETARI:** Deputeti Hyseni, a ke pyetje tjetër, apo...?

DRITON HYSENI: Po, kryetar!

*(Problem teknik me zërin)*

KRYETARI: A keni problem me mikrofon, zoti Hyseni, apo çka është puna?  
Te cili mikrofon dëshironi të flisni?

DRITON HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Shpresoj shpejt t'i evitojmë këto probleme teknike.

Pyetja shtesë që kam për ministren në çështjen e projektit "Solar for Kosovo" është se çfarë do të thotë projekti i tillë për tendencën tonë drejt energjisë së pastër dhe sa në total do të rrisë nivelin e përqindjes që ne do të kemi si vend të energjisë së pastër të prodhuar në vend dhe gjithashtu do të më interesonte fakti i projekteve të tjera të radhës, që kanë për synim ngritjen e nivelit të përqindjes që ne si vend të prodhojmë energji të pastër. Faleminderit!

KRYETARI: Fjala e ministres.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Faleminderit shumë!

Atëherë, sa i përket energjisë termike, domethënë energjisë për ngrohje, aktualisht kapaciteti i koogjenerimit është 140 MW. Ndërsa, po i shtohen me këtë projekt edhe 70 MW, që do të thotë se për 50% po rritet kapaciteti i ngrohjes qendrore në Prishtinë vetëm me këtë projekt.

Sa u përket projekteve të tjera në energji të ripërtërishme janë disa duke u planifikuar dhe duke ndodhur paralelisht. I pari është projekti për një park solar, të parin në Kosovë, në tokën e KEK-ut, kapacitet prej 100 MW. I dyti parashihet të jetë investim nga sektori privat, në bazë të pilot-ankandit që do të lansohet deri në fund të vitit, me kapacitet 50 – 100 MW. Ndërsa, vitin tjetër pritet të lansohen edhe projekte të tjera, ankande të tjera për energji me erë ose solare.

Kjo i bie që brenda tre vjetëve të ardhshme, deri në vitin 2025, ne të kemi së paku 200 MW të reja për prodhimin e energjisë së ripërtërishme, që i bie gati së paku dyfishim i kapaciteteve aktuale për burime të ripërtërishme të energjisë deri në fund të mandatit.

Mirëpo, brenda kësaj kohe do të fillojnë procedurat edhe për lansimin e ankandëve, ose ndërtimin edhe të kapaciteteve edhe më të mëdha. Faleminderit!

KRYETARI: Tash, një pyetje është e deputetit Milazim Salihaj. Pyetjen deputeti ia drejton ministrit Liburn Aliu, por ministrin nuk e kemi këtu në seancë.

Urdhëro, deputet!

MILAZIM SALIHAI: Faleminderit, kryetar!

Pyetjen do ta bëj kur të jetë i pranishëm edhe ministri Aliu.

KRYETARI: Kalojmë te pyetja e fundit për sot, që është pyetja e deputetit Luan Aliu. Pyetjen e ka për ministren Rozeta Hajdari. A e kemi deputetin këtu? Po, urdhëro!

LUAN ALIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

E nderuar zonjë ministre Hajdari,

Pas miratimit të Ligjit nr. 08/L-018 për tregti me produktet e naftës dhe karburantet e ripërtëritshme dhe vendimit të Qeverisë për caktimin e marzhës së fitimit të tregtarëve me pakicë e shumicë të karburanteve, ministria juaj ka nisur mbikëqyrjen e këtyre rregullimeve ligjore.

A mund të na informoni se si është gjendja në terren dhe sa raste të shkeljeve keni evidentuar dhe çfarë natyre kanë ato dhe si do të vijojë më tej mbikëqyrja dhe parandalimi i këtyre abuzimeve?

KRYETARI: Urdhëro ministre, fjala është e juaja për t'u përgjigjur.

MINISTRJA ROZETA HAJDARI: Faleminderit, i nderuar kryeparlamentar!

Të nderuar deputetë,

Faleminderit edhe deputetit për pyetjen!

Po! Në lidhje me zbatimin e Ligjit për karburantet e naftës dhe karburantet e ripërtëritshme ne e kemi zbatuar e ligjit. Ministria ka filluar me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për tregtinë me produktet e naftës dhe karburanteve të ripërtëritshme dhe në bashkëpunim me inspektorët e ATK-së jemi bërë edhe mbikëqyrjen e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me përcaktimin e marzhës tregtare me shumicë dhe pakicë të karburanteve në fjalë dhe inspektimet janë realizuar kryesisht te operatorët ekonomikë që kanë një rrjet të gjerë të shitjes edhe me pakicë në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe me të gjitha njëzet rastet e inspektuar, kemi gjetur tejkalime të marzhës së përcaktuar.

Pra, kemi gjetur shkelje dhe këto janë iniciuar edhe në gjykatë. Ndërsa, në lidhje me zbatimin e ligjit, janë kryesisht 380 inspektime që janë realizuar dhe po ashtu edhe ato janë duke u përcaktuar edhe me masat sipas ligjit në fuqi. Ne do të vazhdojmë tutje me inspektime. Është e rëndësishme që edhe Inspektorati i Tregut në nivelin komunal dhe ATK po bashkëpunon dhe tutje më shumë do të koordinohemi edhe me zbatim të neneve të tjera të ligjit të ri për naftën dhe karburantet e ripërtëritshme. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Aliu a ke pyetje tjetër për ministren.

LUAN ALIU: Jo, kryetar! Në rregull është. Faleminderit!

KRYETARI: Tash po hyjmë në shqyrtimin e Projektligjeve.

Deputetët i thërrasim që të kthehen në sallë, sepse po vazhdojmë me pika të tjera. kemi edhe dy projektligje të rëndësishme për FSK-në për t'i votuar, ju lutem kthehuni në sallë.

Zini vendet tuaja, deputetë!

### **3. Miratimi i procesverbalit nga seancat plenare, të mbajtura më 28 prill dhe 11 maj 2022**

Deputetë të nderuar,

Po e votojmë fillimisht, po e miratojmë faktikisht procesverbalin.

Në sallë janë 66 deputetë. Nëse nuk keni vërejtje për procesverbalet e mbajtura të seanca plenare të mbajtura më 28 prill dhe 11 maj, atëherë konstatoj që nëse nuk keni vërejtje, procesverbalet u miratuan.

Kalojmë te pika tjetër:

### **4. 4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-074 për turizmin**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Ekonomi e ka shqyrtuar Projektligjin për turizmin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij bashkë me amendamentet e propozuara.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën e Republikës si dhe me ligjet në fuqi.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë parimet bazë të legjislacionit të BE-së.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit nuk e ka shqyrtuar raportin me amendamente brenda afatit të përcaktuar sipas Rregullores së Kuvendit.

Ia japim fjalën kryetarit të Komisionit Funkcional për Ekonomi, deputetit Ferat Shala, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit. Urdhëroni z. Shala.

FERAT SHALA: Faleminderit, kryetar!

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-074 për turizmin ka kaluar të gjitha procedurat e duhura sipas Rregullores së Kuvendit dhe Komisioni për Ekonomi, Turizëm e Ndërmarrësi, praktikisht

ka rekomanduar që të miratohet dhe pasi i plotëson të gjitha konditat, lehtëson shumë procedura, bën përmirësimin e sferës së turizmit më shumë se kurrë, i rekomandon Kuvendit që të miratojë këtë projektligj.

**KRYETARI:** Faleminderit!

Dëshironi ta merrni fjalën edhe në emër të PDK-së, zoti Shala? Po, urdhëro! Grupet parlamentare.

**FERAT SHALA:** I nderuar kryetar!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nevoja për përmirësimin e legjislacionit për turizmin ka qenë e kahershme, përkundër që e kemi pasur dhe e kemi aktiv një pjesë të kësaj strukture legjislative. Konsiderojmë që zhvillimet e fundit në sferën ekonomike të vendit, në situatën e krijuar pas pandemisë, në situatën e krijuar pas krizës... dhe në situatën e përgjithshme globale kapacitetet tona zhvillimore ekonomike duhet të fuqizojnë përmirësimin e legjislacionit në fushën e turizmit, duke krijuar mundësi dhe lehtësi për ndërmarrjet turistike të vendit dhe duke krijuar kompatibilitet në proceset legale të Bashkimit Evropian dhe legjislacioneve në fuqi.

Në këtë relacion, ky projektligj plotëson gamën e përgjithshme të të bërit biznes në fushën e turizmit dhe krijon kushte dhe atmosferë më të mirë turistike për gjithë sektorin e vendit dhe bashkëpunimin rajonal. Andaj, grupi ynë parlamentar do ta mbështesë këtë punë, me bindjen e plotë që kjo do të mbështetet edhe nga grupet e tjera parlamentare.

**KRYETARI:** Ia japim fjalën Grupit të Vetëvendosjes. Deputeti Driton Hyseni e paraqet qëndrimin e grupit.

**DRITON HYSENI:** Faleminderit kryetar!

Përshëndetje për të gjithë,

Projektligji për turizmin ka për qëllim të caktojë parimet standarde dhe rregullat bazë për zhvillimin dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm në Republikën e Kosovës. Përmes këtyre rregullave përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike në fushën e turizmit si dhe kriteret e funksionimit, të drejtat dhe përgjegjësitë e agjencive turistike, udhërrëfyesve turistikë, strukturave akomoduese, tur-operatorëve dhe subjekteve të tjera që veprojnë në fushën e turizmit.

Objektivat kyçe të projektligjit janë përafrimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian, krijimi i bazës ligjore të mirëfilltë për mbështetjen e zhvillimit të turizmit konkurrues dhe të qëndrueshëm dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore, kulturore, njerëzore dhe financiare. Pra ligji i ri do të

ofrojë një bazë homogjene ligjore për shërbimet turistike duke ndihmuar në zhvillimin e pakove turistike dhe mbrojtur turistët.

Të nderuar deputetë,

Ligji do të rregullojë gjithë veprimtarinë e turizmit në Republikën e Kosovës dhe si rezultat do të kemi përfitime nga ana e të gjitha institucioneve shtetërore, ekonomisë dhe qytetarëve, sepse do të kemi një shumëllojshmëri të shërbimeve turistike, shërbime turistike të siguruara dhe mbi të gjitha presim rritjen e numrit të turistëve që vizitojnë vendin tonë.

Të nderua kolegë deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje shprehim qëndrimin pro këtij ligji dhe ju ftoj të gjithëve për mbështetje të ligjit me votë. Gjithsesi dëshiroj të falënderoj edhe kolegët e opozitës për punën në grupet punuese dhe për procedimin me kohë të ligjeve që i kemi në procedim parlamentar. Faleminderit të gjithëve!

**KRYETARI:** Meqë nuk ka të tjerë të paraqitur, propozoj të shkojmë në votimin e amendamenteve të këtij projektligji.

Në sallë i kemi 70 deputetë. Po i shqyrtojmë amendamentet një nga një.

A dëshironi që t'i votojmë amendamentet përnjëherë? Grupet parlamentare pajtohen? Mirë.

75 deputetë jemi. Po i hedhim menjëherë në votim këto të gjitha.

Propozoj që me ngritje dore të deklaroheni prej amendamentit 1 deri në amendamentin 17.

Kush është për të shtatëmbëdhjetë amendamentet e propozuara për këtë Projektligj për turizmin? 75 deputetë jemi në sallë.

Kush është kundër? Kush abstenon?

73 deputetë kanë votuar. Të gjitha votat për, asnjë kundër, asnjë abstenim. I konsideroj këto amendamente të gjitha të miratuara.

Tash e votojmë Projektligjin së bashku me të gjitha amendamentet e miratuara.

Kush është për Projektligjin për turizmin? Kush është kundër? Kush abstenon?



Për Projektligjin për turizmin kanë votuar 76 deputetë. Të gjitha votat për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kështu që konstatoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi Projektligjin për turizmin bashkë me amendamentet e miratuara.

Kalojmë në pikën e pestë të kësaj seance:

## **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-113 për Policinë Ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes e ka shqyrtuar Projektligjin për Policinë Ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij bashkë me amendamentet e propozuara.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji bashkë me amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm, përveç nenit 13, paragrafët 5 dhe 6, që duhet të harmonizohen me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Në bazë të rekomandimit të Komisionit për Legjislacion, në raportin e fundit me amendamentet e propozuara, e ka harmonizuar nenin 13 si dhe paragrafët 5 dhe 6 të këtij projektligji me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se çështjet e rregulluara dhe të adresuara në këtë projektligj dhe përmes amendamenteve të propozuara nuk rregullohen në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.

Kurse, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthim nuk e ka shqyrtuar fare raportin me amendamente brenda afatit të përcaktuar sipas Rregullores së Kuvendit.

E ftojme kryetari e Komisionit Funkcional për Çështje të Sigurisë, deputetin Bekë Berisha, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e Komisionit Funkcional.

**BEKË BERISHA:** Faleminderit kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes si komision Funkcional dhe raportues e ka shqyrtuar Projektligjin për Policinë Ushtarake dhe raportin me gjithsej 14 amendamente ia ka paraqitur Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Këto amendamente janë të harmonizuara dhe me Kushtetutën e ligjet e tjera të Kosovës. prandaj, ftojme deputetët që t'i mbështesin ato.

Miratimi i këtij projektligji do të mundësojë avancimin e bazës ligjore për policinë ushtarake, pasi aktualisht kjo çështje është e rregulluar me akte nënligjore. Po ju njoftoj se ne edhe si grup parlamentar e mbështesim. Faleminderit!

KRYETARI: Ky ishte po ashtu, edhe z Bekë Berisha e dha edhe qëndrimin e grupit parlamentar. Nëse nuk ka të tjerë të paraqitur. Grupet parlamentare nëse ka një pajtueshmëri që e mbështetni. U paraqit Enver Dugolli. E paraqet qëndrimin e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes.

ENVER DUGOLLI: Faleminderit kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Projektligji për Policinë Ushtarake është një hap i rëndësishëm në fuqizimin e ushtrisë sonë, i cili po vjen së bashku me frymën e angazhimit të përditshëm të Qeverisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes për investime dhe përkrahjen substanciale për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Misioni i ri i FSK-së i marrë nga ky parlament para më shumë se tri vitesh, na obligon që të mos lëmë asnjë hapësirë apo boshllëk ligjor i cili do të na pengonte dhe do ta pengonte Forcën në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve ligjore si brenda vendit, ashtu edhe në misione të ndryshme paqësore së bashku me aleatët tanë.

Ky projektligj gjithashtu formëson strukturën dhe përgjegjësitë në raport me ndjeshmërinë e misionit, duke vendosur mekanizma sigurues karshi kërcënimeve dhe devijimeve të ndryshme si brenda Forcës ashtu edhe jashtë saj.

Raportet e komunikimit dhe komunikimet që rregullohen me këtë ligj, edhe me organet e tjera ligjzbatuese të sigurisë në Kosovë, janë përplotësim i njëra-tjetrës dhe rrisin efikasitetin e luftimit e parandalimit të rreziqeve, shkeljeve ligjore brenda kazermave dhe jashtë tyre në mision. Gjithashtu vlen të theksohet se policia ushtarake do të veprojë konform kornizave ligjore dhe do të bashkëpunojë ngushtë me forcat aleate duke parandaluar çdo veprim që synon veprimtarinë ligjore të FSK-së, mirëpo autoriteti i policisë ushtarake do të zbatohet asnjëherë ndaj forcave mike dhe aleate siç janë KFOR-i dhe misionet e tjera në Kosovë.

Ky mekanizëm po ndërtohet konform rregullave dhe praktikave të shteteve mike me standarde më të larta të ushtrive të vendeve anëtare të NATO-s, duke rritur bashkëpunimin dhe interaktivitetin në ruajtjen edhe forcimin e sigurisë dhe mbrojtjes.

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjatë kohës ndërmjet dy leximeve kemi punuar ngushtë dhe intensivisht edhe me grupet parlamentare pozitë-opozitë, duke adresuar të gjitha çështjet, në mënyrë që të kemi një ligj sa më

të mirë, të zbatueshëm, në harmoni me legjislacionin në fuqi, Kodin Penal si dhe me misionin dhe detyrat e FSK-së.

Ashtu siç u tha edhe më herët, ne kemi adresuar edhe çështjen që Komisioni për Legjislacion na ka rekomanduar, d.m.th. nenin 13 e kemi harmonizuar, gjegjësisht paragrafin 5 dhe 6 me Kodin e Procedurës Penale.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e mbështet këtë projektligj dhe i fton të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës që ta mbështesin me votën pro. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Ky ishte qëndrimi i Vetëvendosjes. Tash qëndrimi i PDK-së. Qëndrimin e grupi e jep deputeti Berisha.

**HISEN BERISHA:** I nderuar kryetar!

Ministra e deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet këtë ligj, i cili do ta mbështesë policinë ushtarake të Forcës në përmbushjen e obligimeve që dalin në përmbushjen e misionit të Forcës.

Ky e bën policinë tonë dhe Forcën të jenë interoperabile dhe të integruara në mision. Vlera përmbajtjesore e këtij ligji është në nivelin e standardeve të ushtrive bashkëkohore. E uroj policinë ushtarake, e uroj ministrin. Suksese përpara!

**KRYETARI:** Tash e dëgjojmë edhe qëndrimin e Lidhjes Demokratike. Deputeti Anton Quni.

**ANTON QUNI:** Faleminderit kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet projektligjin në fjalë. Ne në kuadër të komisionit i kemi dhënë të gjitha këto vërejtjet dhe sugjerimet, jemi harmonizuar dhe është qëndrim i përbashkët që këtë projektligj edhe ta votojmë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Grupi Multietnik po ashtu e paraqet qëndrimin e vet. Deputeti Erxhan Galushi e ka fjalën.

**ERXHAN GALUSHI:** Faleminderit kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar Multietnik si dhe nënkryetari i Komisionit për Siguri e mbështesim Projektligjin për Policinë Ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës. faleminderit!

**KRYETARI:** Me sa po e shoh pra prej grupeve parlamentare ka një konsensus për ta votuar këtë ligj, kështu që sa i përket amendamenteve a pajtoheni që t'i votojmë të gjitha përnjëherësh? Grupet parlamentare.

14 amendamente janë të propozuara. 72 deputetë po marrin pjesë në seancë. Kështu që i hedhim këto amendamente fillimisht në votim.

Deputetë të nderuar, po i hedhim në votim të katërmbëdhjetë amendamentet e propozuara për Projektligjin për Policinë Ushtarake të FSK-së.

Kush është për këto amendamente? Kush është kundër? Kush abstenon?

74 deputetë kanë votuar për këto amendamente. Të gjithë e kanë dhënë votën e tyre për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kështu që u miratuan 14 amendamentet e projektligjit.

Tash e hedhim në votim Projektligjin së bashku me amendamentet e miratuara.

Kush është për Projektligjin për Policinë Ushtarake të FSK-së? Kush është kundër? Kush abstenon?

74 deputetë kanë votuar për Projektligjin për Policinë Ushtarake të FSK-së. Të gjithë e kanë dhënë votën e tyre për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kështu që, konstatoj që Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin nr. 08/L-113 për Policinë Ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Pika e gjashtë e rendit të ditës është:

## **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-133 për Komisionarin Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Çështje të Sigurisë e ka shqyrtuar Projektligjin për Komisionerin Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Ia japim fjalën deputetit Anton Quni. Apo e keni caktuar dikë tjetër, zoti Quni? Bekë Berisha, kryetari. E ftojme kryetarin e komisionit, Bekë Berisha, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

BEKË BERISHA: Faleminderit!

Ky është Projektligji nr. 08/L-133 për Komisionarin Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

I nderuar kryetar i Kuvendi,

Të nderuar deputetë,

Ky Projektligj për Komisionarin Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës është nisme legjislative e Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Me këtë ligj mundësohet themelimi i institucionit të Komisionarit Parlamentar për FSK-në.

Ky institucion do të ndikojë në fuqizimin e ushtrimit të kontrollit civil dhe demokratit ndaj FSK-së dhe do të ndikojë në avancimin e të drejtave të personelit ushtarak të FSK-së.

Ky projektligj përbëhet nga shtatë krerë dhe 28 nene të strukturuar, si në vijim: Dispozitat e përgjithshme, dispozitat kryesore, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Çështjet kryesore që rregullohen me këtë projektligj janë: zgjedhja e Komisionarit, kompetencat, metodologjia e punës, bashkëpunimi me institucionet e tjera, si Komisioni Funkcional, çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes, Kuvendin e Kosovës, Avokatin e Popullit dhe organet e sistemit të drejtësisë.

Projektligji krijon implikime buxhetore nga hyrja e tij në fuqi dhe për zbatimin e tij duhet të parashihet vijë e veçantë buxhetore. Çështjet të cilat rregullon ky projektligj nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së, dhe si i tillë nuk i cenon parimet bazë të legjislacionit të BE-së.

Nga komisioni edhe në emër të Komisionit Funkcional dhe raportues i rekomandojmë Kuvendit miratimin e tij në parim, dhe gjatë shqyrtimit ndërmjet dy leximeve mund të ketë edhe plotësime të tjera nëse shihen të nevojshme. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tani e kanë fjalën grupet parlamentare. Në emër të Vetëvendosjes, deputetja Shqipe Mehmeti-Selimi.

**SHQIPE MEHMETI-SELIMI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Pozita dhe roli institucional i Komisionarit Parlamentar për FSK-në ndihmon dukshëm në fuqizimin e kontrollit demokratik dhe civil ndaj FSK-së dhe adresimin e çdo rasti që ka të bëjë me respektimin e të drejtave të personelit ushtarak të FSK-së.

Një praktikë e tillë tanimë është e zhvilluar në vendet demokratike perëndimore dhe atë shumë vite më parë. Gjatë procesit të përgatitjes së këtij projektligji, në kuadër të Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, ne kemi pasur rast të dëgjojmë nga ekspertët gjermanë dhe holandezë përvojat e tyre në themelimin dhe fushëveprimtarinë e komisionarëve brenda ushtrive të tyre dhe e kemi kuptuar domosdoshmërinë që edhe FSK-ja duhet ta ketë një institucion të tillë.

Në këtë projektligj, ne ndërtojmë edhe një standard që tanimë e kanë vendet e NATO-s, me anë të rritjes së kontrollit civil dhe demokratik mbi ushtrinë. Me këtë projektligj, personeli ushtarak i FSK-së mund të adresojë respektimin e çdo të drejte të që i takon brenda shërbimit në ushtri.

Andaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, ju ftoj ta përkrahni këtë nismë ligjore dhe të votoni për. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ky ishte qëndrimi i Vetëvendosjes. Tash qëndrimi i PDK-së nga deputeti Hisen Berisha.

**HISEN BERISHA:** I nderuar kryetar,

E përgëzoj komisionin, i përgëzoj të gjithë ata që kanë punuar ndër vite për të pasur një ligj dhe komisionar apo ombudsperson ushtarak. Po ndihem shumë mirë, edhe pse s'përfitoj vetë, sepse kam vuajtur shumë nga padrejtësisë në zhvillimin e karrierës. Të paktën tash e tutje ata që janë brenda do ta kenë një avokat mbrojtës që do t'i mbrojë e tyre për zhvillimin e karrierës dhe për avancim.

I uroj suksese ministrit, i uroj suksese të gjithë atyre që shërbejnë në Forcë. T'i ruajnë të gjitha pietetet më të larta që i gëzojnë si ushtarakë, sepse e vetmja është uniforma që të jep krenari dhe nder shumë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash qëndrim e Lidhjes Demokratike, deputeti Anton Quni.

**ANTON QUNI:** Faleminderit, kryetar!

Ju lus që të keni pak vëmendje dhe durim! Do t'i marr disa minuta më shumë nga fakti që të shpreh falënderim për të gjithë ata që kanë punuar në inicimin e këtij projektligji dhe të cilët me vite e kanë trajtuar. Janë në pyetje disa legjislacione. Është një ndër projektligjet që më së shumti ka marrë kohë.

Prandaj, thjesht një kronologji e ngjarjeve, posaçërisht për deputetët e rinj, të cilët nuk janë të familjarizuar me këtë projektligj.

Nisma legjislative Projektligji për komisionarin parlamentar për Forcën e Sigurisë është propozuar për herë të parë në Legjislaturën e katërt. Si ide-propozim i ishte paraqitur Komisionit Funkcional për Çështje të Sigurisë, nga ish-komisionari i Bundestagut Gjerman i Forcave të Armatosura të Gjermanisë, zoti Rajnhold Robi.

Komisioni Funkcional për Çështje të Sigurisë në vijim ishte pajtuar me këtë propozim dhe në Legjislaturën e Katërt të Kuvendit ka hartuar Projektligjin për Komisionarin e Kuvendit, i cili

do të ishte përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut për pjesëtarët e dy institucioneve të sektorit të sigurisë; për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe për Policinë e Kosovës.

Arsye për këtë nismë legislative ishin forcimi i kontrollit civil parlamentar dhe mbikëqyrja demokratike ndaj institucioneve të sigurisë. Dhe e dyta, avancimi dhe afirmimi i mbrojtjes së drejtave të personelit të FSK-së dhe Policisë së Kosovës, forcimi i bashkëpunimit dhe partneritetit me shtetin gjerman dhe komisionarin është konsideruar si një institucion që shërben si urë bashkëpunimi ndërparlamentar dhe atë të forcave të armatosura mes dy shteteve.

Kjo nismë legislative, parimisht ishte përkrahur nga deputetët e të gjitha grupeve parlamentare në komision. Gjithashtu, edhe ministritë përkatëse me përfaqësuesit e tyre, me ekspertizën e tyre kanë qenë pjesë e grupit punues për hartimin e projektligjit.

Gjatë procesit të hartimit të projektligjit, komisioni është mbështetur GIZ-i gjerman dhe personalisht nga zoti Robi, po ashtu me asistencën e zyrtarëve të OSBE-së.

Si model për hartimin e këtij projektligji është marrë model i Komisionarit Parlamentar gjerman dhe Komisionari Parlamentar i Bosnjës-Hercegovinës, por edhe janë konsultuar edhe modelet e ngjashme të vendeve të tjera, posaçërisht të shteteve të rajonit apo të Ballkanit Perëndimor.

Ndërsa hartimi i dispozitave ligjore është sipas teknikës legislative vendore dhe janë zbatuar modelet e institucioneve të tjera, si për shembull; paga, kriteret përzgjedhëse, shkarkimi e të tjera.

Fushëveprimi i këtij projektligji është sui generis dhe nuk ndërhyjnë në fushëveprimin e asnjë institucioni tjetër. Por, pavarësisht se Komisioni Funkcional përfundoi hartimin e kësaj nisme legislative, projektligji nuk u proceduar për shqyrtim dhe miratim.

Mosprocedimi dhe miratimi i këtij projektligji ka ndodhur për dy arsye; ndërrimi i shpeshtë i legjislativave, përsëritja e procedurave nga fillimi i nismës legislative dhe procesi i avancimit të FSK-së me mandat ushtarak të mbrojtjes.

Me vendimin nr.1/174 të 6 marsit 2014, Qeveria e Kosovës propozoi 16 amendamente kushtetuese me qëllim të transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.

Amendamenti 16, i propozuar për ndryshimin e Kushtetutës, ishte në përmbajtje si vijon: Komisionari Parlamentar për Forcat e Armatosura edhe Policinë e Kosovës është institucion i

pavarur, i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës, dhe e dyta, roli, detyra dhe përgjegjësitë e Komisionarit Parlamentar do të përcaktohen me ligj të veçantë.

Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin e saj e kishte certifikuar këtë propozim-amendament se është në pajtim me Kushtetutën, por për shkak të procedurave të vështira për ta ndryshuar Kushtetutën dhe mosgatishmërinë e deputetëve të komunitet serb për t'i votuar ndryshimet kushtetuese, ato nuk janë proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Më 14 tetor 2018, Kuvendi i Kosovës ka miratuar pakon e ligjeve përmes të cilave është krijuar baza ligjore për avancimin e mandatit ushtarak të saj.

Ligji nr. 06/1-124 për shërbim në Forcën e Sigurisë, në nenin 3.1.13 përcakton: “Komisionari Parlamentar për FSK është organ i pavarur që zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës, që mbron të drejtat e personelit të FSK-së. Funksionimi dhe kompetencat e këtij institucione rregullohen me ligj të veçantë”.

Pas avancimit të mandatit të FSK-së me mandat burimor ushtarak, komisioni në Legjislaturën e gjashtë ka rikualibruar fushëveprimin e projektligjit vetëm për personelin ushtarak të FSK-së, duke e hequr nga fushëveprimi Policinë e Kosovës, kjo pasi është në pajtim edhe me modelet e vendeve të tjera, edhe pse organizata e sigurisë si policia dhe forcat e armatosura kanë dallime në organizim, mandat dhe mision.

Mungesa e deputetëve në votimet në Kuvend dhe mandati i shkurtër i Legjislaturës së gjashtë dhe të shtatë kanë pamundësuar shqyrtimin dhe miratimin e kësaj nisme legjislative.

Komisioni në Legjislaturën e tetë e ka radhitur në kuadër të planit të punës për vitin 2021, dhe kishte prapë një takim me zotën Rajnlod Robi dhe më pas ka formuar grupin e punës për këtë çështje.

Grupi i punës ka mbajtur disa takime, kemi marrë ekspertiza, dhe në mbledhjen e mbajtur më 1 mars 2022, kemi miratuar versionin përfundimtar të projektligjit dhe është pajtueshmëri e përfaqësuesve të të gjitha partive politike që këtë projektligj ta procedojmë dhe ta miratojmë. Faleminderit për vëmendje!

**KRYETARI:** Deputetë, ta dëgjojmë njëri-tjetrin kur flasim, ju lutem! Grupi Multienik, Erxhan Galushi e ka fjalën.



ERXHAN GALUSHI: Faleminderit, kryetar!

Duke e parë rëndësinë e këtij projektligji, si dhe evitimin e çfarëdo shkelje të të drejtave brenda Forcës së Sigurisë së Kosovës, e shohim si jashtëzakonisht të rëndësishëm këtë projektligj, dhe si Grup Parlamentar Multietnik e përkrahim projektligjin në fjalë.

KRYETARI: Tash radha e deputetëve. Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar! Nuk kam çfarë të flas shumë. Vërtet i mbështes të gjitha ato që i tha kolegu nga Lidhja Demokratike, Anton Quni, i cili e bërë një përshkrim në detaje, që nga iniciativa për themelimin e këtij projektligji.

Gjithsesi, e ndiej si obligim moral që t'i falënderoj dy ish-kolegë tanë të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, ata janë, bashkëpartiaku ynë, Fatmir Xhelili, i cili ka punuar shumë në këtë projektligj, e po ashtu është edhe Rexhep Selimi, i cili ka qenë pjesë e grupit punues dhe ka punuar me një vullnet të jashtëzakonshëm dhe ka kontribuar maksimalisht që sot ta kemi këtë projektligj në Kuvend.

Prandaj, dua t'i uroj ata për këtë të arritur për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe t'i falënderoj për kontributin e dhënë.

KRYETARI: Disa po e shtojnë edhe emrin e Ahmet Isufit. Përmendje me vend. Grupet parlamentare i dhanë qëndrimet e tyre, po ashtu deputetë të tjerë nuk kemi të paraqitur për diskutim për këtë projektligj.

Nëse e do fjalën Qeveria, ministri, në rregull, nëse jo, atëherë shkojmë në votim të këtij projektligji. Sa deputetë i kemi, ju lutem?! 65 deputetë jemi të pranishëm edhe të tjerë të cilët po vijnë.

Do ta votojmë Projektligjin për Komisionarin Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Kush është për, Projektligjin për Komisionarin Parlamentar të FSK-së? Kush është kundër?  
Kush abstenon?

68 deputetë kanë votuar për këtë projektligj, të gjitha votat janë për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Kështu që, konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Komisionarin Parlamentar për FSK-në.

E ngarkojmë Komisionin FunkSIONAL dhe komisionet e tjera që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe pastaj të na e sjellin atë në një rën prej seancave të ardhshme, ashtu siç parashihen afatet me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës.

Me këtë e mbyllim këtë seancë. Mirupafshim!

*E përgatiti:*  
*Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*